

VENDIM
Nr.45, datë 24.1.2007

**PËR SHPALLJEN E GJIREVE TË RAGUZËS, 1 E 2, PORTE PËR STREHIMIN E
MJETEVE DETARE TË SEKUESTRUARA, MJETEVE DETARE NË RREZIK PËR
NGJARJE TË JASHTËZAKONSHME DHE TË MJETEVE DETARE JASHTË
PËRDORIMIT
(PORT RIFUXHO)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 6 e 7 të nenit 18 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjireve të Raguzës, 1 e 2, porte për strehimin e mjeteve detare të sekuestruara, të mjeteve detare, në rrezik për ngjarje të jashtëzakonshme, dhe të mjeteve detare jashtë përdorimit (port rifuxho).

2. Të gjitha mjetet detare të sekuestruara, mjetet, që përbëjnë rrezik për ndotjen e mjedisit apo për sigurinë në porte, si dhe ato jashtë përdorimit, të transferohen në gjiret e Raguzës, 1 e 2.

3. Të gjitha shpenzimet, për kryerjen e lëvizjes së mjeteve, vendosjen e tyre në gjiret e Raguzës, 1 e 2, kryerjen e shërbimeve dhe të veprimeve tregtare mbi mjetet, që do të strehohen në këto gjire, të përballohen nga pronari i këtyre mjeteve detare. Në rastet urgjente administrata e porteve mund të procedojë për lëvizjen e këtyre mjeteve në gjiret e Raguzës, 1 dhe 2, për llogari të shpenzimeve të pronarëve të këtyre mjeteve.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha